

UDHËZIM
Nr. 64, datë 12.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA TË DHËNIES SË
CERTIFIKATËS, PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË EKSPERTIT PRIVAT NË
FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikën 4, të nenit 49, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

UDHËZOJ:

I. KRITERET E VEÇANTA PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË

1. Drejtoria e Përgjithshme e shërbimit të MZSH-së, jep certifikatë, sipas formatit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, për certifikimin profesional të ekspertit zjarrfikës privat, të klasifikuara si më poshtë:

- a) “Kryerja e akteksptimeve për zjarret e rëna”;
- b) “Hartimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- c) “Kryerja e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”.

2. Për pajisjen me certifikatë të tipit “Kryerja e akteksptimeve për zjarret e rëna”, subjekti fizik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë përfunduar arsimimin e lartë në Akademinë e Sigurisë, në Arsimin e Lartë Ushtarak ose të jetë i diplomuar në degët Inxhinierisë, minimumi niveli “Bachelor”;
- b) të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune si punonjës të nivelit mesëm dhe të nivelit të lartë të shërbimit zjarrfikës;
- c) të ketë përfunduar kualifikimin përkatës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të certifikuar në Akademinë e Sigurisë, ose në një nga qendrat e trajnimit zjarrfikës brenda dhe jashtë vendit.

2.1 Subjektet fizike të huaja duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në gerrat “a”, “b” dhe “c”, si dhe të kenë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimimin, diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

3. Për pajisjen me certifikatë të tipit “Hartimi i dokumentacionit të projekteve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, subjekti fizik vendas apo i huaj duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të disponojë diplomë të nivelit “Master profesional apo shkencor”, në degët “Inxhinieri Ndërtimi”, “Inxhinieri Hidroteknike”, “Inxhinieri Fizike”, “Inxhinieri e Proceseve Kimike”, “Inxhinieri Elektrike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Arkitekturë dhe Urbanistikë” dhe “Inxhinieri Gjeologji dhe Miniera”;

- b) të ketë vjetërsi pune mbi 5 vjet në fushën e projektimit të objekteve;

- c) plotësimin e dokumentacionit sipas kreut III të këtij udhëzimi.

3.1 Subjektet fizike të huaja duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuar në gerrat “a” dhe “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij kreu, si dhe të kenë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimimin, diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

3.2 Subjekti juridik vendas apo i huaj mund të aplikoj për pajisjen me certifikatë të tipit “Hartimi i dokumentacionit të projekteve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin” në emër të drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në gerrat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij kreu. Në këtë rast subjekti duhet të paraqesë në dokumentet e mëposhtme në platformën elektronike *e-Albania*;

- a) kontratë pune, në të cilën duhet të rezultojë që drejtuesi teknik i shoqërisë duhet të jetë në marrëdhënie pune me subjektin juridik, për një periudhë kohe jo më pak se një vit;

- b) plotësimin e dokumentacionit sipas kreun III, të këtij udhëzimi.

4. Për pajisjen me certifikatë të tipit “Kryerja e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” subjekti fizik vendës apo i huaj duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar arsimimin në nivelin “Bachelor” në Akademinë e Sigurisë, Arsimin e Lartë Ushtarak, ose të jetë i diplomuar në një nga degët e “Inxhinierisë”;

b) të ketë eksperiencë jo më pak se 5 vjet në shërbimin zjarrfikës si punonjës të nivelit të mesëm dhe të nivelit të lartë të shërbimit zjarrfikës ose të jetë certifikuar në Akademinë e Sigurisë dhe në qendrat e trajnimit zjarrfikës brenda ose jashtë vendit;

c) Plotësimin e dokumentacionit sipas kreut III të këtij udhëzimi.

4.1 Subjekti fizik i huaj duhet të plotësoj kriteret e përcaktuara në germat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 4, të këtij kreu, si dhe të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

4.2 Subjekti juridik vendas apo i huaj, mund të aplikojë për certifikatë të tipit “Kryerja e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” në emër të drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në germat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 4, të këtij kreu.

II. OBJEKTI I PUNËS SË EKSPERTIT ZJARRFIKËS PRIVAT

1. Eksperti zjarrfikës privat i certifikuar “Për kryerjen e aktekspertizave për zjarret e rëna”, kryen:

a) ndihmon në këqyrjen e vendit të ngjarjes, ku ka rënë zjarri;

b) studimi i dosjes hetimore lidhur me ngjarjen.

c) hartimin e aktekspertizës kur caktohet nga institucionet e prokurorisë, gjykatës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile, si dhe kur kërkohet nga personat fizik.

2. Eksperti zjarrfikës privat i certifikuar “Për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, kryen:

a) hartimin e dokumentacionit të projektit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin për të gjitha llojet e objekteve dhe veprave të ndryshme në përputhje me legjislacionin përkatës;

b) përgatitjen e relacionit teknik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

3. Eksperti zjarrfikës privat i certifikuar “Për kryerjen e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, kryen:

a) trajnime që lidhen me dhënien e njohurive në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit për subjekte të ndryshme juridikë apo fizikë, publikë, me përjashtim të personelit të shërbimit të MZSH-së apo privatë;

b) organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve, takimeve, apo ushtrimeve demonstrative me institucione dhe subjekte të ndryshme për dhënien e njohurive mbi masat e mbrojtjes nga zjarri;

c) hartimin e programeve të stërvitjes në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

III. KËRKESA PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË EKSPERTIT ZJARRFIKËS PRIVAT DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Subjekti i interesuar për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, duhet të aplikojë *online* nëpërmjet portalit *e-Albania* dhe ngarkon dokumentacionin;

a) kërkesë për tu pajisur me certifikatën e ekspertit zjarrfikës privat sipas kategorizimit;

b) fotokopje e diplomës e noterizuar;

c) jetëshkrim;

d) 1 fotografi me përmasa 4 x 6 cm;

e) akti i regjistrimit në QKB (ekstrakt QKB);

f) dokumentacion teknik justifikues për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV: vërtetime nga subjekte, institucione, certifikata kursi trajnimi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkohet të licencohet. Të gjitha dokumentet justifikuese të kenë të përfshirë NIPT-in, nënshkrimin me vulën e subjektit fizik/juridik, adresën postare ose elektronike të subjektit që ka lëshuar dokumentin.

1.1 Kërkesa për pajisjen me certifikatë dhe dokumentacioni shoqërues i noterizuar duhet të jetë në gjuhën shqipe.

2. Kërkesa për pajisjen me certifikatë shqyrtohet nga një komision i posaçëm, i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, i cili përbëhet nga:

a) drejtor i Inspektimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e PMZSH-së, në cilësinë e kryetarit;

b) 1 specialist i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, në cilësinë e anëtarit;

c) 1 specialist në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit të Kuadrit Rregullator, në cilësinë e anëtarit.

3. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës, trajton dhe vlerëson dokumentacionin e dorëzuar brenda 25 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe vendos, për:

- a) plotësimin e dokumentacionit;
- b) refuzimin e kërkesës;
- c) dhënien e certifikatës.

4. Certifikata për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat është pa afat dhe i prodhon efektet nga data e marrjes së saj.

5. Komisioni mbështetet nga Sekretariati Teknik, nga një specialist në Drejtorinë e PMZSH-së i cili kryen funksionin e Sekretariatit Teknik.

6. Në mbledhje, komisioni shqyrton aplikimet, dokumentacionin e paraqitur nga Sekretariati Teknik.

7. Mbledhjet e Komisionit mbahen në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.199, “Për funksionimin e organeve kolegjiale”.

8. Komisioni i përcaktuar në pikën 2, të kreut III, për shqyrtimin e kërkesës trajton dhe vlerëson dokumentacionin e dorëzuar brenda 25 ditëve nga momenti i konfirmimit nga punonjësi i sekretariatit teknik, si dhe vendos, për:

- a) refuzimin e kërkesës duke evidentuar shkakun e refuzimit;
- b) dhënien e certifikatës.

9. Sekretariati Teknik në rastet kur identifikon mungesë në dokumentacionin e kërkuar për aplikim, vë në dijeni komisionin dhe njofton aplikantin për plotësimin e tij.

10. Vendimet në komision si rregull merren me konsensus. Kur konsensusi nuk arrihet vota e kryetarit është përcaktuese.

11. Vendimet në Komision përgatiten nga Sekretariati Teknik dhe nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.

12. Mbi bazën e vendimit të komisionit lëshohet certifikata e ekspertit zjarrfikës sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

13. Komisioni i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së mund të revokojë certifikatën e ushtrimit të aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në rast se:

- a) është lëshuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.
- b) vërtetohet se personi fizik apo juridik ka përdorur dokumente të falsifikuara për t’u pajisur me certifikatë;

c) konstatohet shkelja e rregullave për përpilimin e aktekspertimeve, të hartimit të dokumentacionit teknik të projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor dhe qendror.

14. Ndaj vendimit të Komisionit, subjektet aplikues kanë të drejtën e ankimit pranë ministrit përgjegjës, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit.

15. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankesës brenda 15 ditëve kalendarike vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni;
- b) rikthim për rishqyrtim të vendimmarrjes së komisionit.

16. Lidhur me mos pranimin e ankesës sipas piks 14 të këtij udhëzimi, subjekti ka të drejtën e ankimit në gjykatën administrative.

IV. ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së administron regjistrin e gjithë ekspertëve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, sipas kategorizimit të pikës 1 të këtij udhëzimi.

2. Regjistri i ekspertëve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin përmban identitetin, arsimimin e subjektit, data e lëshimit të certifikatës, adresën elektronike edhe kontaktin e telefonit.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 11, datë 10.12.2002, i ish-ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për kriteret profesionale të dhënies së lejes për ushtrimin e ekspertit privat zjarrfikës”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BREND SHËM
Bledar Çuçi